



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 01

Datë: 28. 03. 2019. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:
2. Aktivitetet e ZRPP-së:

-Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për Vitin 2019.

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Kosovës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Gjilan, Prishtinë, Istog, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Lipjan, Viti,

Pejë, Novobërdë, Rahovec, Vushtrri, Gjakovë, Glllogoc, Podujevë, Zubin Potok, Suharekë dhe Skenderaj;

5. Të ndryshme:

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Mbledhja e sotshme e KQZ-së, kishte në fokus emërimin e tetë (8) anëtarëve të rinj të KQZ-së nga Presidenti i Republikës, z. Hashim Thaçi. Valdete Daka, kryetare, përgëzoi anëtarët e rinjë. Unë, në emrin tim personal dhe në emër të KQZ-së, tha znj. Daka, ju dëshiroj punë të mbarë dhe shpresoj që së shpejti do t'i kemi edhe dy anëtarët e tjerë, që ende nuk janë emëruar. Rendine ditës e keni marrë, dhe ju pyes se, a pajtoheni me këtë rend dite ? S'ka vërejtje, kush është për këtë rend dite ?

Pa ndonjë vërejtje, sugjerim, propozim etj., anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

Nga aktivitetet e ZRPP-së, anëtarët e KQZ-së u njoftuan lidhur me pikën: “Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike Parlamentare për Vitin 2019.” Pa debat, anëtarët e KQZ-së e miratuan këtë vendim.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, shqyrtuan dhe miratuan rekomandimin e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për kandidatin e radhës për deputet të Kuvendit të Kosovës.

Valdete Daka: qe një kohë të gjatë, kemi një kërkesë nga Zyra e Presidentit për deputetin e radhës, cili do ta zëvendësoj deputetin Nezir Çoçaj nga PDK.

Nëse nuk ka ndokush për të shtuar, meqë edhe dokumentacioni është komplet, unë e hedh në miratim zëvendësimin: deputeti Nezir Çoçaj, zëvendësohet nga Rafet Rama. Kush është për...? Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në Gjilan, Prishtinë, Istog, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Lipjan, Viti, Pejë, Novobërdë, Rahovec, Vushtrri, Gjakovë, Glllogoc, Podujevë, Zubin Potok, Suharekë dhe Skenderaj.

Valdete Daka: Vazhdojmë me zëvendësimin e asamblistëve komunal. Për të qenë më funksional, administrata e ka përgatitur një listë të asamblistëve që pritet të zëvendësohen. Kryetarja Daka, i komunikoi një nga një asamblistët që kanë dhënë dorëheqje, dhe ata që do të jenë asamblistë të rinj. Po ashtu, anëtarët e KQZ-së, i miratuan ata një nga një:

	Komuna	Emërohet anëtar i Kuvendit Komunal	Zëvendëson anëtarin e Kuvendit Komunal	Subjekti politik
1	Gjilan	Renan Imami	Kadir Huseyin	KDTP
2	Gjilan	Xhevat Demiri	Nazim Gagica	AAK
3	Gjilan	Rijad Elezi	Ramiz Ramadani	LDK
4	Gjilan	Isa Agushi	Faton Bislimi	LDK
5	Prishtinë	Arbër Vokrri	Milot Podvorica	LVV
6	Prishtinë	Hafiz Krasniqi	Sokol Havolli	LDK
7	Istog	Riza Dreshaj	Enver Rugova	LDK
8	Istog	Labinot Aliaj	Lulzim Shoshi	PDK
9	Istog	Ruzhdi Metaj	Hajrush Shoshi	LDK
10	Mitrovica e Jugut	Asllan Isufi	Esat Peci	AAK
11	Mitrovica e Jugut	Remzi Rrahmani	Alban Fazliu	PDK
12	Mitrovica e Jugut	Nysret Cubreli	Besnik Beka	AKR
13	Mitrovica e Veriut	Dušan Milutinović	Oliver Ivanović	GI SDP-Oliver Ivanović
14	Lipjan	Arif Miftari	Diamant Bytyqi	LDK
15	Lipjan	Fatime Krasniqi	Linda Shahini	LDK
16	Viti	Zejnepe Osmani	Vjollca Kadolli-Halili	LDK
17	Viti	Taibe Ibrahim	Rufadije Halimi Rexhepi	LDK
18	Pejë	Drita Haxhijaj	Xhevahire Çeku Kelmendi	PDK
19	Pejë	Gyltene Zeka	Xhenet Syka Kelmendi	LDK
20	Novobërdë	Zymer Zymeri	Bajrush Ymeri	LDK

21	Novobërdë	Jahi Zeqiri	Xhevat Mehmeti	LDK
22	Rahovec	Fehmi Hoxha	Astrit Thaçi	PDK
23	Rahovec	Saranda Sallteku	Floriqe Boshnjaku	AAK
24	Rahovec	Shqipe Tara-Sokoli	Bjondina Kleqka	AAK
25	Vushtrri	Hajriz Mustafa	Lutfi Bilalli	AAK
26	Vushtrri	Fitim Halili	Sami Istrefi	PDK
27	Gjakova	Rrok Luli	Halit Isufi	PDK
28	Gjakova	Xhavit Alijaj	Faton Gutaj	AAK
29	Glllogoc	Gentrit Gërguri	Xhavit Drenori	IQZ Vizioni për Drenasin
30	Glllogoc	Florentina Kukaj	Shqipe Zogu	PDK
31	Prizren	Islam Ukaj	Kujtim Gashi	PDK
32	Podujeva	Bunjamin Hoti	Mirsad Kamerolli	LDK
33	Zubin Potok	Jahir Kamberi	Vedat Mehmeti	LVV
34	Suharekë	Lirim Qatani	Salih Bytyqi	AAK
35	Skenderaj	Dorata Ndreshaj	Drenushë Hajzeri-Geci	AKR

4. Të ndryshme

Valdete Daka: A ka ndokush ndonjë pyetje në të ndryshme...?

Florian Dushi: Do të kërkoj nga Sekretariati, meqë, ka kaluar kohë e gjatë dhe se mos zëvendësimi i këtyre asambleistëve subjekteve politike nëpër kuvende komunale ju ka shkaktuar telashe të mëdha, një mobilizim të menjëhershëm që vendimet për zëvendësim t'u përcillen menjëherë kuvendeve komunale.

Adnan Rustemi: Shëni, ju uroj anëtarëve të rinj suksese në punën e tyre. Nëse, në frymën e asaj që tha Floriani pajtohem plotësisht, por Sekretariati le të mobilizohet edhe në alokimin e mjeteve subjekteve politike. Të përmbushen procedurat, sepse ka më shumë se tre muaj që subjektet janë pa fondin shtetëror...

Valdete Daka: Gjithësesi, unë do të nënshkruaj vendimet menjëherë...Ju uroj pra, edhe njëherë punë të mbarë, dhe shpresoj që të takohemi sa më shpejt...Falemnderit edhe njëherë...